

Universi në xhepin tim

Të zbulojmë Diellin,
Tokën
dhe Qiellin



Grażyna Stasińska
Observatori i Parisit



Pamja e Diellit në qiell

Le Soleil

Ç'është një gjë e rrumbullakët
dhe e verdhë,

Që lind e perëndon?

Që na ndriçon e na ngroh
përditë?

E që natën zhduket?

Dielli

Dielli është një top zjarri.

Në sipërfaqen e tij ndodhin shpërthime
që mund të dëmtojnë telekomunikimin
në Tokë.

Pa Diellin nuk do të kishte jetë në Tokë,
sepse ai i jep energji bimëve për t'u
rritur e ato na furnizojnë me ushqim
dhe me oksigjen për të marrë frymë.

Drita e Diellit bën 8 minuta për të
mbërritur në Tokë.

Një foto e Diellit, e marrë me filtër special
(SOHO). Protuberancat shihen qartë.



Një pejsazh në Tokë

Ç'është një gjë e rrumbullakët,
E mbuluar me ujra, male, pyje,
dhe me shkretëtira,
Dhe ku jetojnë me miliona lloje
qëniesh të gjalla?



Foto e Tokës, e marrë nga një satelit i NASA-s.
Shihet Amerika e Veriut dhe e Jugut.

Dihet prej kohësh që Toka nuk është e sheshtë, siç mund ta besonim duke parë rrotull nesh. Ajo është e rrumbullakët si një top.

Toka sillet rrotull Diellit, por meqë jetojmë në Tokë, na duket sikur Dielli sillet rreth saj.

Në saje të tërheqjes që Toka ushtron mbi ne, ne ecim kudo mbi sipërfaqen e saj, pa fluturuar në hapësirë.



Një pamje e Hënës

Është e verdhë

Dhe ndriçon zbehtë natën.

Nganjëherë na shfaqet e rumbullakët,

Hera-herës i ngjan një drapëri.



Drapëri i Hënës

« në këmbë »

Foto nga Gary Hart

Drapëri i Hënës

« i shtrirë »


Foto nga Tavi Greiner

Orientimi i drapërit të Hënës varet nga ora, stina dhe vendi mbi Tokë nga e shohim.

Hëna sillet rreth Tokës dhe ndriçohet nga Dielli.

Njerëzit kanë ecur mbi Hënë në 1969, 1971 dhe 1972. Meqë Hëna nuk ka atmosferë, ata u desh të mbanin veshje speciale për të marrë frymë.

Meqë pesha mbi Hënë është 6 herë më e lehtë se pesha mbi Tokë, këto veshje që peshonin mbi 70 kile i ndjenin krejt të lehta.



Planetet

Disa mund t'i shohim me sy të lirë, si pika të vogla të ndritshme në qiell.

Me teleskop mund të shquajmë formën e rrumbullt dhe ngjyrat e tyre.

Planetet



Fotomontazh që tregon planetet në rendin e tyre të distancës nga Dielli (për t'i treguar të gjitha, nuk janë respektuar madhësitë dhe distancat).

Disa planete kanë unaza. Unazat e Saturnit njihen prej kohësh dhe mund të vrojtohen me një teleskop amatorësh.

Planetet

Rreth Diellit sillen 8 planete. Ato janë, sipas rradhës: Mërkuri, Afërdita, Toka, Marsi, Jupiteri, Saturni, Urani dhe Neptuni. Disa janë shkëmbore, të tjerat janë të gazta.

Disa kanë hëna, si Toka (që ka vetëm një).

Në Galaksi janë zbuluar me mijëra planete që sillen secili rreth diellit të vet.



Natë me yje

Yjet

I shohim si pika xixëlluese në qiell, sapo bie nata.

Aty ku ka shumë, dritat e tyre përzihen në një fashë të shtrirë e të gjatë me emrin Rruga e Qumështit.

Yjet

Yjet janë topa zjarri, si Dielli ynë. Por ndodhen shumë shumë më larg. Ata na duken si pika xixëlluese.

Yjet nuk kanë të njejtën ngjyrë: të bardhat dhe blutë janë më të nxehta, të verdhat kanë temperaturën që ka Dielli, të kuqet janë më të ftohta.

Me sy të lirë mund të shihen disa mijëra. Në Rrugën e Qumështit ka me miliarda yje.

Një foto e qendrës së Rrugës së Qumështit, e marrë në Brazil nga B. Tafreshi. Djathtas shihet yjësia e Kryqit të Jugut.



Yjet që "bien"

Na duken si flashe drite, që përshkojnë qiellin sa hap e mbyll sytë.

Shpesh vijnë në grupe.

Yjet që "bien"




Një "shi" yjesh që "bien" në Kili. Rrezet e ndritshme duken sikur vijnë nga e njejta pikë.
(foto nga Yuri Beletsky)

Yjet që bien


Nuk janë yje, por grimca të vogla që vijnë nga hapësira. Këto grimca digjen kur hyjnë në atmosferë dhe lënë një gjurmë drite.

Kur Toka kalon në trajektoren e ndonjë komete, që ka shpërndarë re pluhurash pas vetes, ne shohim një « shi yjesh që bien ».

« Shirat » më të forta ndodhin në Gusht dhe Tetor.



“Qielli i përbashkët”, një vepër kolektive artistësh nga Australia dhe Afrika e Jugut.



“Qielli dhe stinët”, vepër e artistit Inuite Kenojuak Ashevak.

Si e imagjinoj unë qiellin

Universi në xhepin tim n° 34

Grażyna Stasińska, e Observatorit të Parisit, e shkroi këtë minilibër në vitin 2022 dhe ia ka dedikuar nipit të saj 5 vjeç, Côme. Vizatimet i ka bërë Arsen, 8 vjeç.

Faqja e fundit e librit jep dy paraqitje të ndryshme të qiellit, të imagjinuara nga artistë të hemisferës jugore (sipër) dhe të hemisferës veriore (poshtë).

Po ti, si e imagjinon qiellin?

Vizatoje në faqen anash.



Për të ditur më shumë mbi këtë koleksion dhe çështjet e paraqitura në këtë minilibër, mund të konsultoni faqen <http://www.tuimp.org>.

Përkthimi: Mimoza Hafizi
TUIMP Creative Commons

